



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA E ZBATIMIT TË POLITIKAVE STRATEGJIKE DHE INTEGRIMIT

Nr. 7106 Prot.

Tiranë, më 12. 10. 2022

NJOFTIM

Komisioni Evropian ka publikuar Raportin vjetor të 2022 për Shqipërinë në të cilin ka dhënë gjetjet dhe rekomandimet përkatëse sa i takon Kapitullit 5: Prokurimi Publik.

Në përgjithësi, KE ka vlerësuar se Shqipëria është **mesatarisht e përgatitur** në prokurimet publike. Është bërë një **Progres i Mirë** gjatë periudhës së raportimit, veçanërisht sa i takon miratimit të legjislacionit dytësor në zbatim të ligjit të ri për prokurimin publik dhe lançimit të një sistemi elektronik të ankesave. Gjithashtu, nga KE vihen në dukje arritje të tjera sa i takon zhvillimit të trajnimeve në fushën prokurimin publik, publikimit të raportit të parë të monitorimit për strategjinë e prokurimit publik dhe vendosjen e “të dhënave të hapura”/open data në kohë reale për procedurat e prokurimit dhe duke përfshirë risqet e korrupsionit të lidhura me prokurimin në planet e integritetit të institucioneve.

Për të lexuar materialin e plotë për Kapitullin 5, bashkëlidhur këtij njoftimi gjeni raportin të përkthyer në gjuhën shqipe.

Duke ju falënderuar,

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Reida Kashta

